



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ven. nr. 01/1252 Dt. 10 / 06 / 2021

Në mbështetje të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 pika 1.1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i universitetit në mbledhjen e XXIV të radhës të mbajtur më datë 03.06.2021, mori:

V E N D I M

Miratohet raporti i Komisionit të Studimeve, ku refuzohet zgjedhja e Dr.Sc. Sylë Ukshini në thirrjen akademike Profesor asistent në Fakultetin Juridik.

Arsyetim

Senati i universitetit në mbledhjen e XXIV të mbajtur më 03.06.2021, ka miratuar raportin e Komisionit të Studimeve ku ka refuzuar zgjedhjen në thirrjen akademike Profesor Asistent në Fakultetin Juridik të Dr.Sc. Sylë Ukshini, pasi që i njëjti nuk i plotëson kushtet sipas nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Ref.nr. 01/625 dt.12.06.2020, sepse kandidati nuk ka dëshmuar se ka së paku një punim shkencor të publikuar në revista shkencore të indeksuara në platformat e caktuara sipas Rregullores dhe udhëzimit administrativ të MASHT Nr. 01/2018.

Senati i universitetit në mbledhjen e XXII me datë 04.03.2021, për të sqaruar edhe një herë lidhur me punimin shkencor, ka kthyer edhe një herë për rishqyrtim në Komision të Studimeve që të shikohet saktë se a ka kandidati në fjalë një punim shkencor në revistat apo platformat e caktuara sipas Rregullores dhe Udhëzimit administrativ të MASHT. Komisioni i Studimeve në raportin me nr.05/1072 dt.21.05.2021, ka konstatuar se i përmenduri nuk i plotëson kushtet për tu zgjedhur në thirrjen akademike Profesor Asistent pasi që nuk e ka së paku një punim shkencor të publikuar në revista shkencore të indeksuara në platformat e caktuara sipas Rregullores së UKZ-së nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Rregullores Ref.nr.01/325 dt.12.06.2020 dhe Udhëzimit administrativ të MASHT Nr. 01/2018.

Në bazë të asaj që u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Senatit



Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor



Vendimi i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Arkivit

Këshill Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas publikimit në ueb faqe dhe dërgimit në mënyrë elektronike palës, Komisionit për ankesa dhe parashtresa të Senatit, që shërben si instancë e fundit e ankimit në UKZ.